



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3101/ 8 prot.

Datë 20.11.2025

V E N D I M

Nr. 1728/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.11.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-60070-09-02-2025, me objekt: “Sherbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat e SHRUKD sh.a”, me fond limit 25,097,400.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës Sh.A

Lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik “Albdesign PSP” SHPK në procedurën e sipërcituar të prokurimit

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-60070-09-02-2025, me objekt: “Sherbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat e SHRUKD sh.a”, me fond limit 25,097,400.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës Sh.A

Lënien të skualifikuar dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit të operatorit ekonomik “Albdesign PSP” SHPK në procedurën e sipërcituar të prokurimit

Ankimues:

Operatori ekonomik “Adel Co” SHPK me NIPT L22117021M dhe adresë: Rr.Efendiu Nr.13,Tirane 1050, Tiranë

Operatori ekonomik “Inpress” SHPK me NIPT L52122014L dhe adresë: Rruga “Siri Kodra” ish-blloku i magazinave tregtare-Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A me adresë: “L.17 Rr. Dalip Peza, Durrës

Subjekte të Interesuara:

Operatori ekonomik “Inpress” SHPK me NIPT L52122014L dhe adresë: Tiranë, Ish Blloku i Magazinave të Tregtisë, Rruga Siri Kodra

Operatori ekonomik “Adel Co” SHPK me NIPT L22117021M dhe adresë: Rr.Efendiu Nr.13,Tirane 1050, Tiranë

Operatori ekonomik “Albdesign PSP” SHPK me NIPT L51819005Q dhe adresë: Tiranë, Kashar, Rruga Çerçiz Topulli Nr.17 - 1051

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik “Adel Co” SHPK ka plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit/entit kontraktor.

I.5. Operatori ekonomik “Inpress” SHPK nuk ka plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit/entit kontraktor.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03.09.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr REF-60070-09-02-2025, me objekt: “Sherbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat e SHRUKD sh.a”, me fond limit 25,097,400.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.

II.2. Në datën 03.10.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 13.10.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Naol” SHPK	pa ofertë ekonomike	skualifikuar
2. “Albdesign” SHPK	22,156,000.00 lekë	skualifikuar
3. “Inpress” SHPK	22,499,800.00 lekë	kualifikuar
4. “Adel Co” SHPK	24,830,000.00 lekë	kualifikuar

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik, më datë 24.10.2025, rezulton se është publikuar në SPE, Njoftimi i Fituesit Paraprak.

II.5. Në datën 31.10.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/6029 si dhe nr. Protokolli 3101/2025 datë 31.10.2025 e operatorit ekonomik “Adel Co” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr REF-60070-09-02-2025, me objekt: “Sherbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat e SHRUKD sh.a”, me fond limit 25,097,400.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetellës Kanalizime Durrës Sh.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit, si dhe lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik “Albdesign PSP” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 3101/1 prot., datë 03.11.2025.

II.7. Me datë 04.11.2025 operatori ekonomik “Inpress” SHPK ka paraqitur në sistemin e ankesave elektronike formularin e argumentave i cili u protokollua me tonën me nr. 3101/2 prot., datë 05.11.2025.

II.8. Me datë 07.11.2025 autoriteti kontraktor përmes shkresës me nr. 2285/40 prot., datë 07.11.2025 ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike vendimin për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Adel Co” SHPK protokolluar me tonën me nr. 3101/3 prot., datë 07.11.2025, nga ku rezulton, se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës duke argumentuar:

KSHA, pasi u njoh me dokumentat e publikuara në SPE - DST, dhe parashtrimet me shkrii të ankimuesit në lidhje me s'kualifikimin, veren se:

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, KSHA konstatoi se Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, KSHA konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në ligjin nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”.

2. Operatori ekonomik ka paraqitur ankesë duke respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor, bazuar në Nenin 110 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë. Si dhe referuar Neni 97 të VKM Nr. 285, Datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave Të Prokurimit Publik”, pika 2;

-Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës, ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës, ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.

Në këto kushte KSHA-ja mori në shqyrtim ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

Ankesa e OE : Vlerësimi i KVO-së ka qënë sipërfaqësor, aspak formal dhe thelbësor duke kualifikuar oferta të pavlefshme që nuk janë në përputhje me specifikimet teknike dhe kriteret e vecanta të kualifikimit.

1. Në pikën 2.3.8 të DST-të është kërkuar OE pjesëmarrës për realizimin e kontratës të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme;

- 3 (tre) makineri dixhitale (2 për prodhim normal dhe 1 për rezervë në rast defekti). Të paktën 2 nga makineritë duhet të jenë me ngjyra. Disponimi i makinerikeve duhet vërtetuar me faturë blerje ose dokument zhdoganimi ose cdo formë tjetër disponimi që njeh Kodi Civil i RSH. Edhe në rastin e marrjes me qera nga

kompani tjetër, duhet paraqitur kontrata qirasë e vlefshme bashkangjitur fatura e blerjes, ose cdo formë tjetër disponimi që njeh Kodi Civil i RSH

- Operatori duhet të paraqesë kartelën teknike të makinerive nga të cilat duhet të rezultojnë se makineritë kanë një kapacitet jo më pak se 1041 fletë A4/ore të printuara nga të dyja anët.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën, në kopje origjinale ose të noterizuara, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Ankuesi ankohet se Firma Inpress ka marrë pjesë edhe në vitin 2023 me të njëjtin objekt dhe të njëjtat kriterë dhe është s'kualifikuar për arsyet;

- OE nuk përmbush kapacitetin teknik pika 2.3.8 pasi
? Kartela teknike për makinerinë me fature 282/22 " Makineri pajisje dixhitale Ricoh Pro C910S" nuk ka emer dhe firme perkthyesi,por vetem noterizim.
? kartelat teknike të paraqitura për makinerinë sipas faturës Nr 904/2022 " Printer Ricoh 8110" nuk janë për këtë paisje por për Ricoh Pro 8110EX dhe 8110S.
? Nuk ka paraqitur karte teknike për makinerinë sipas faturës Nr 282/22 "Paisje zarfimi Pitney Boëes DI 350"
? Kërkesat e tjera të vecanta për kualifikim pasi;pesha e mostrës së letrës nuk është sipas specifikimeve të kërkuara,kjo referuar analizës së kryer në një Laborator testimi të njëres prej mostrave, ku konstatohet se pesha e letrës është më e vogël se 92 g/m2.

Ankuesi pretendon se -Cfarë ka ndryshuar nga nga vit 2023 ne 2025 pasi nga informacionet që ka ky subjekt ka dorëzuar të njëjtat dokumenta, dhe është cudi që në vitin 2025 ka ndryshuar situata. Pasi pretendon se;

- a) Përkthimi i makinerive Ricoh Pro C901S nuk është sipas Ligjit 82/2021 Per perkthimin zyrtar dhe profesionion e perkthyesit si dhe Urdherit te Ministrisë së Drejtësisë nr 189 dt 04.05.2022 i perditësuar " Per miratimin e formes dhe permbajtjes se deklarates tip të nënshkruar nga perkthyesi zyrtar; Perkthimi duhet te jete i plote dhe besnik ndaj origjinalit, ne cdo faqe te perkthimit duhet te permbaje vulen dhe firmen e perkthyesit te licensuar, ti bashkangjitet origjinalit dhe ne fund te jete deklarë e perkthyesit zyrtar sipas formes ne Udhezim.

-b) Kartela e makinerise Ricoh 8110 e paraqitur me faturën nr 904/22 Printer Ricoh 8110" nuk perputhet me kete makineri por me makinerine Ricoh 8110s dhe Ricoh Pro 8110EX.

Sipërfundim OE Ankues pretendon se nga 3-tre makineri OE fitues ka paraqitur vetem 2 dhe si perfundim duhet te skualifikohet nga kjo procedure

KSHA vëren se:- Nga shqyrtimi i dokumentave të paraqitur në sistem dhe të cituara nga ana e OE si dhe nga ato të paraqitura me ankesën dhe proces verbalin e vlerësimit, OE fitues duhet të paraqeste sipas kërkesave të kriterit teknik pika 2.3.8

- 3 (tre) makineri dixhitale (2 për prodhim normal dhe 1 për rezervë në rast difekti). Të paktën 2 nga makineritë duhet të jenë me ngjyra. Disponimi i makinerikeve duhet vërtetuar me faturë blerje ose dokument zhdoganimit ose cdo formë tjetër disponimi që njeh Kodi Civil i RSH. Edhe në rastin e marrjes me qera nga kompani tjetër, duhet paraqitur kontrata qirasë e vlefshme bashkangjitur fatura e blerjes, ose cdo formë tjetër disponimi që njeh Kodi Civil i RSH
- Operatori duhet të paraqesë kartelën teknike të makinerive nga të cilat duhet të rezultojnë se makineritë kanë një kapacitet prej jo më pak se 1041 fletë A4/ore të printuara nga te dyja anët.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën, ne kopje origjinale ose te noterizuara, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

-Sa më sipër, kriteri do të quhej i përmbushur me paraqitjen e 3-tre makinerive, faturat për disponimin e tyre ose cdo dokument që njeh Kodi civil, si dhe skedat teknike.

-Ne sistemin SPE OE -INPRESS ka paraqitur Faturën nr 282/2022 ku ka 2-dy Makineri /paisje dixhitale Ricoh Pro C901S shoqëruar me dhe skeda teknike të perkthyer noterizuar.

-Faturën nr 3023/2023 ku ka disa artikuj, në pikën 1 është artikulli FOTOKOPJE ACCURIO PRESS C4070 shoqëruar me Skedën teknike e perkthyer dhe noterizuar.

Pra, OE i kualifikuar e ka përmbushur këtë kriter me paraqitjen e 3-tre makinerive.

Sa i takon përkthimit të skedës teknike të makinerisë Ricoh Pro C901S dhe formës së përkthimit, KSHA konstaton se skeda teknike e një makinerie nuk ndryshon sipas viteve, dhe kjo makineri është perkthyer në vitin 2020 dhe ska si të ketë formën e një Udhëzimi të dalë në vitin 2022, por gjithashtu Urdhëri i Ministrisë nuk ka si të ketë fuqi prapavepruese. Gjithashtu në lidhje me perkthyesin zyrtar dhe mungesën e firmës së tij, KSHA vëren se, sipas nenit 62 pika j të Ligjit 110/2018 'Kopetencat e Noterit - j) *bën ose vërteton përkthime nga një gjuhë në një tjetër, vetë ose nëpërmjet një përkthyesi të licencuar, të pranuar nga palët ose kërkuesi*; Pra ligji nuk e ndalon Noterin nëse është apo ka qënë në kohën që është bërë përkthimi i licencuar të bëjë edhe perkthimin e materialit.

Nga sa më sipër KSHA arsyeton se: Ankesa e bërë në lidhje me këtë pikë nga OE, nuk merret në konsideratë.

2. OE ankohet se në pikën 2.3.1 Të aftësisë teknike dhe profesionale është kërkuar;

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Ankuesi pretendon se firma Inpress nuk e plotëson këtë kriter ,pasi ajo ka paraqitur disa fromularë të thjeshtë, shtypshkrime që nuk përputhen me objektin e prokurimit. Gjithashtu nuk ka dorëzuar vertetime nga institucione publike që të mbështesin vlerën e kërkuar e të jenë në përputhje me objektin e kërkuar.

Për sa më sipër sipas ankuesit firma Inpress nuk e plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3.1 të punëve të ngjashme dhe duhet të s'kualifikohet.

KSHA vëren se:- nga shqyrtimi i dokumentacionit për përmbushjen e këtij kriteri janë paraqitur nga OE Inpress dokumentacioni si më poshtë:

- Vertetim realizimi nga OSHEE me nr 6519/1 prot dt 21.07.2025 për Kontraten e realizuar me sukses me nr 4282/15 prot dt 18.07.2022 me vlere 45,720,000 me tvsh, ku ka qënë si BO me 55 % . Kontraten dhe faturat elektronike me sasite dhe vlerat.
- Vertetim realizimi nga Shoqeria Rajonale Ujesjelles kanalizime Gjirokaster Sha me nr 1659/1 prot date 16.07.2025 per realizimin me sekses te kontratave me nr 455/16 prot dt 15.02.2023 me vlere 1,675,800 pa tvsh dhe asaj me nr 1292/12 prot dt 31.05.2024 me vlerë 1,099,026 pa tvsh, shoqeruar me kontratat dhe faturat elektronike.
- Dhe me sektorin privat ka paraqitur fatura tatimore me sherbime me te njejtin objekt me prokurimin.

Sa më sipër KSHA vëren se vetëm me kontratat e paraqitura me sektorin publik OE Inpress e ka përmbushur këtë kriter.

Nga sa më sipër KSHA arsyeton se: Ankesa e bërë në lidhje me këtë pikë nga OE, nuk merret në konsideratë.

3. OE ankues pretendon se , në pikën 2.4.1 Kërkesat e vecanta është kërkuar:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë 10 (copë) fatura sipas të gjitha specifikimeve teknike të kërkuara ne DST ne datën dhe orën e caktuar si afat i fundit per dorezimin dhe hapjen e ofertave.

Sipas informacioneve që ky operator ka, modelet e paraqitura nga OE Inpress nuk janë në përputhje me specifikimet teknike, konkretisht gramatura nuk është 90gr, formati i zarfimit nuk është sipas specifikimeve teknike dhe ngjyra blu e logos nuk është në tonalitetin e kërkuar. Dukej me sy të lirë që letra nuk është sipas parametrave të kërkuara. OE ankues ngren pretendimin se ne vitet e mëparshme është kërkuar nga KVO dhe KPP kryerja e analizës së mostrave nga Laborator të certifikuar, akredituar. Sa më sipër Ankuesi kërkon për saktësinë e mangësive të pretenduara kampionet e paraqitur nga Inpress dhe OE Albdesign të dërgohen për analizë në laborator të akredituar.

KSHA vëren se:- Në pikën 2.4.1 Kërkesat e vecanta është kërkuar:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë 10 (copë) fatura sipas të gjitha specifikimeve teknike të kërkuara ne dst, ne datën dhe orën e caktuar si afat i fundit per dorezimin dhe hapjen e ofertave.

Ditën e hapjes së ofertave të gjithë OE e interesuar janë paraqitur dhe nga ana e KVO-së është mbajtur edhe proces verbali i paraqitjes së mostrave. Në DST-të nuk është kërkuar apo specifikuar në asnjë pikë se mostrat do të dërgohen për testim në laborator, dhe cdo veprim i bërë në kundërshtim me sa parashikohet në DST do të sillte diskriminim dhe sjellje jo propocionale të AK, kundrejt OE të interesuar. Në rast se OE Ankues ka patur këtë pretendim ka patur të gjithë mundësinë të ankohej që në fazën e shpalljes së DST-ve dhe të kërkonte modifikimin e këtij kriteri, por dhe me pas në ditën e paraqitjes së mostrave , ku ka firmosur pa rezerva në proces verbalin e mostrave me nr 2285/30 prot datë 03.10.2025 dhe nuk ka paraqitur asnjë kundërshtim apo kërkesë.

Referuar VKM-së 285/2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik e ndryshuar, - Neni 40 Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave, pika 6 ,gërma a) -

Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces.

Pika 8: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

Sa më sipër Ligji i lejon OE të interesuar të paraqesin Kërkesa për modifikim, ndryshim apo shtim dhe heqje të kritereve sipas KREU XIV Ankimi Administrativ Neni 109 e në vijim, OE ankues e ka patur të gjithë kohën të ankohet nëse ka patur dyshime të argumentuara.

Sa më sipër Neni 2 " Qëllimi i ligjit" 162/2020 "Për prokurimin publik" ,

Qëllim i këtij ligji është:

të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3 Parime të përgjithshme

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

Nga sa më sipër KSHA arsyeton se , OE Inpress shpk ka paraqitur dokumentacion në përputhje me kërkesat e Autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit, e për rrjedhojë i ka përmbushur kërkesat për kualifikim.

Nga sa më sipër KSHA arsyeton se: Ankesa e bërë në lidhje me këtë pikë nga OE, nuk merret në konsideratë.

Përsa më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, në mbështetje të pikës 3 të nenit 114 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM-se, nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 100, pika 2;

Vendosi:

- Të mos marrë në konsideratë ankesën e paraqitur nga Operatori Ekonomik "ADEL CO", për vlerësimin e tenderit për prokurimin me objekt "Shërbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat të SHRUKD"

II.9. Informacionin më sipër për shqyrtimin e ankesës autoriteti kontraktor e dërgoi në KPP edhe përmes shërbimit postar i cili u protokollua me tonën me nr. 3101/4 prot., datë 11.11.2025.

II.10. Në datën 03.11.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/6041 si dhe nr. Protokolli 3136/2025 datë 04.11.2025 e operatorit ekonomik "Inpress" SHPK për procedurën e prokurimit "E hapur, mbi kufirin e lartë monetar", me Nr REF-60070-09-02-2025, me objekt: "Shërbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat e SHRUKD sh.a", me fond limit 25,097,400.00 lekë pa TVSH, zhvilluar

në datën 03.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit, si dhe lënien të skualifikuar dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit të operatorit ekonomik “Albdesign PSP” SHPK.

II.11. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 3136/1 prot., datë 04.11.2025.

II.12. Me datë 10.11.2025 autoriteti kontraktor përmes shkresës me nr. 2285/42 prot., datë 10.11.2025 ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike vendimin për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK protokolluar me tonën me nr. 3136/2 prot., datë 10.11.2025, nga ku rezulton, se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës duke argumentuar:

KSHA referuar nenit 111 të LPP-së, ka kryer verifikimin e elementëve të ankesës dhe ka konstatuar se Operatori Ekonomik ankimues nuk ka ngarkuar mandat-pagesën e tarifës së ankesës.

Duke qënë se mandat-pagesa e tarifës së ankesës është një element i domosdoshm për shqyrtimin e ankesës, KSHA referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, me datë 04.11.2025 i ka dërguar njoftim me email Operatori Ekonomik ankimues me objekt “Mbi paraqitjen e mandat-pagesës së tarifës së ankesës **brenda 2 ditëve** në lidhje me ankesën e paraqitur”.

Operatori Ekonomik ankimues nuk ka korrigjuar (ngarkuar në S.E.A) mandatin e tarifës së ankesës **brenda 2 ditëve nga vënja në dijeni me email**.

Përsa më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, në zbatim të pikës 2 dhe 3 të nenit 111 të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM-se, nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

Vendosi:

Të vlerësojë si të paparaqitur ankesën e paraqitur nga Operatori Ekonomik “Inpress” sh.p.k, pasi nuk ka plotësuar një element të domosdoshm për shqyrtimin e ankesës nuk ka ngarkuar (paraqitur) mandat-pagesën e tarifës së ankesës për prokurimin me objekt **“Shërbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat të SHRUKD”**.

II.13. Me datë 04.11.2025 operatori ekonomik “Inpress” SHPK ka paraqitur në sistemin e ankesave elektronike formularin e argumentave i cili u protokollua me tonën me nr. 3136/3 prot., datë 10.11.2025.

II.14. Informacionin më sipër për shqyrtimin e ankesës autoriteti kontraktor e dërgoi në KPP edhe përmes shërbimit postar i cili u protokollua me tonën me nr. 3101/4 prot., datë 11.11.2025.

II.15. Me datë 07.11.2025 përmes komunikimit elektronik zyrtar (e-mail) i cili u protokollua me tonën me nr. 3136/5 prot., datë 13.11.2025 autoriteti kontraktor i ka përcjellë KPP-së njoftimin që i ka dërguar operatorit ekonomik “Inpress” SHPK me datë 04.11.2025 me përmbajtje si vijon:

“Përshëndetje,

*Referuar ankesës suaj të publikuar në faqen zyrtare të KPP me Nr. 3136/2025 për procedurën e prokurimit me objekt: **“Shërbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevoja të SHRUKD”** me statusin e mandat pagesës të paparaqitur,*

Ju njoftojmë se bazuar në pikën 2 dhe 3 të nenit 111 të Ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

Për sa më sipër duhet të paraqisni mandatin brenda 2(dy) ditëve nga marrja e njoftimit, me qëllim dokumentimin e tij.

Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve, do të vlerësohet si e paparaqitur.

Mbetemi në pritje të përgjigjes tuaj, ”

II.16. Përmes memos me nr. 3136/6 prot., datë 14.11.2025, KPP ju drejtua Sektorit të Finances, Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve në KPP me kërkesën për informacion si vijon:

“Në datën 04.11.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/6041 si dhe nr. Protokolli 3136/2025 datë 04.11.2025 e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr REF-60070-09-02-2025, me objekt: “Shërbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat e SHRUKD sh.a”, me fond limit 25,097,400.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.

Nga verifikimet e materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se statusi i pagesës për ankesën me numër ankimi A/2025/6041 si dhe nr. Protokolli 3136/2025 datë 04.11.2025 rezulton “pa paguar”.

Sa më sipër me qëllim vijim e shqyrtimit të mëtejshëm të ankesës nga KPP lutem përcjelljen e informacionit mbi statusin aktual të pagesës për ankesën e sipërpërmendur.”

II.17. Përmes shkresës me nr. 3136/7 prot., datë 18.11.2025 Sektori i Finances, Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve në KPP ka informuar se: *“Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. 3136/6 prot., datë 14.11.2025 me lëndë :” Kërkesë për verifikim pagese”, ju bëjmë me dije se për ankesën me nr. 3136/2025 prot., datë 04.11.2025 me numër ankimi elektronik A/2025/6041,*

Operatori ekonomik "Inpress" SHPK nuk ka paraqitur dokument bankar që të vërtetojë kryerjen e pagesës për tarifën e ankimit.

Referuar raportit datë 18.11.2025 të dërguar nga Dega e Thesarit për arkëtimet e kryera deri më datë 14.11.2025, rezulton se Operatori Ekonomik "Inpress" SHPK nuk ka kryer pagesën në favor të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesën e sipërcituar.

II.18. Përmes shkresës nr. 166 prot., datë 19.11.2025 me lëndë "Shkresë në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt:"Shërbim i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat e SHRUKD sh.a" me nr REF-60070-09-02-2025 ng Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A" protokolluar me tonën me nr.3101/5 prot., datë 20.11.2025 operatori ekonomik "Adel Co" SHPK ka paraqitur në KPP argumentat si vijon:

Firma "Adel CO"sh.p.k mori pjese ne proceduren e prokurimit me objekt" Sherbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat e SHRUKD sh.a " me REF-60070-09-02-2025 organizuar nga Shogëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A. Pas vleresimit te ofertave dhe Njoftimit te Fituesit Paraprak firma Adel CO ka bere ankesa online prane Autoritetit Kontraktor dhe Komisionit te Prokurimit Publik.

Pas marrjes se pergjigjes nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A në përgjigjen e dhënë per ankesën tonë, verejme se vendimmarrja e KSHA-se eshte e papranueshme, e pambeshtetur ne ligj dhe me shkelje te qarta te rregullave procedurale.

Ngreme seriozisht dyshimin per paaftesi profesionale ose shkelje te rende te ligjit deri ne nivel dyshimi per korrupsion qe do te ndiqet ne cdo institucion kompetent perfshire edhe SPAK -un.

Ne pergjigjen e dhene te KSHA-se pranohet se firma Inpress ka paraqitur kartela teknike te noteruara ne vitin 2020. Kjo eshte e papranueshme juridikisht pasi procedura e prokurimit zhvillohet ne vitin 2025 dhe dokumentet e paraqitura duhet te jene sipas legjislacionit ne fuqi ne momentin e paraqitjes, dhe jo sipas ligjeve te pese viteve me pare. Pra cdo dokument qe kerkohet te jete i noteluar duhet te jete perkthyer e noteluar ne perputhje me rregullat aktuale.

Pretendimi i KSHA-se se dokumentet e noteruara ne vitin 2020 duhet te pranohen eshte nje gabim juridik i rende qe tregon mosnjohje te ligjit ose favorizim i qellimshem te firmes Inpress. Sipas KSHA-se i bie qe ligjet qe jane miratuar mbas vitit 2020 nuk kane asnje fugi ligjore. Ne vete pergjigjen e KSHA-se pranohet se dokumentet nuk jane ne perputhje te plote me ligjet aktuale, cka perben shkak te qarte se firma Inpress duhet te skualifikohet nga kjo procedure.

Persa i perket elementeve te tjere te ankeses, si per skeden teknike qe firma Inpress ka paraqitur qe eshte per makineri tjeter ne kerkojme me te madhe tek Autoriteti Kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik apo edhe SPAK qe KVO e KSHA nuk ka zbatuar ligjet ne fuqi. Gjithashtu ne pergjigjen e KSHA-se, thuhet se informacioni per gramaturen e letres eshte

"konfidencial" dhe eshte ne tagrin e Autoritetit Kontraktor te beje analizen apo jo sepse sipas AK-se gramatura nuk luan nje rol thelbësor te madh. Ky eshte nje pretendim qe nuk ka asnje baze ligjore dhe eshte perdorur qarte per te shmangur analizen dhe verifikimin real te dokumenteve te firmes Inpress.

Gramatura e letres eshte nje parameter thelbësor ne cdo prokurim te printimit dhe zarfimit dhe nuk ka asnje arsye ligjore qe te mos verifikohet. U bene shume vite qe firma Adel CO operon ne tregun e shtypshkrimeve dhe nuk kemi marre ndonjehere pergjigje te tille nga nje Autoritet Kontraktor.

Per sa me siper, kerkojme nga KPP s'kualifikimin e firmes Inpress pasi edhe nga KSHA jane pranuar mangesite qe ka firma Inpress dhe shpalljen fitues te firmes Adel CO."

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik "Adel Co" SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik "Inpress" SHPK nga procedura e prokurimit, për shkak se sipas tij ky i fundit nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim, pika 2.4.1 konkretisht duke pretenduar se: "3-)Ne piken 2.4.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim eshte kerkuar: Operatori ekonomik duhet të paraqesë 10 (copë) fatura sipas të gjitha specifikimeve teknike të kerkuara ne dst, ne datën dhe orën e caktuar si afat i fundit per dorezimin dhe hapjen e ofertave. Sipas informacioneve qe ne kemi modelet e paraqitura nga firma Inpress nuk perputhen me specifikimet teknike te percaktuara ne dokumentet e tenderit konkretisht per: Gramatura e letres nuk eshte 90gr, formati i zarfimit (preferimi) nuk eshte sipas specifikimeve teknike dhe ngjyra blu e logos nuk eshte ne tonalitetin e kerkuar. Dukej edhe me sy te lire qe letra e modeleve te firmes Inpress nuk eshte sipas parametrave te kerkuara dhe ngjitja e preferimit eshte jashte standarteve te tenderit. Ne procedurat e meparshme, si KVO po ashtu edhe KPP, kane kerkuar dhe kryer analizen e parametrave si (gramatura, permasat dhe percaktimi i ngjyres blu) ne laboratore te akredituar. Ndryshe nga vitet e meparshme, KVO kete here nuk ka kryer analizen laboratorike te mostrave duke lene pa verifikuar perputhmerite teknike te modeleve te paraqitura. Per kete arsye, kerkojme nga Autoriteti Kontraktor dhe KPP-ja, te bejne analizen e modeleve te firmes Inpress ne nje laborator te akredituar, per parametrat e meposhtme:

a) Matjen e gramatures se letres

b) Matjen e permasave te modeleve te dorezuara

c) Percaktimin e ngjyres blu te logos

Po te shikosh modelet e firmes Inpress edhe me shikim te lire, duken shume qarte qe jane me nje leter shume me te holle sesa firmat e tjera. Po ashtu edhe formati i ngjitjes dhe preferimit dhe logoja nuk eshte sipas kerkesave te DST-se. Duke qene se KVO nuk jane eksperte te

licensuar për saktesimin e ketyre mangësive në kërkojme që kampionet e paraqitura nga firma Inpress dhe nga firma Albdesign të dergohen për analizë në një laborator të njohur nga DPA për keto parametra.” KPP vëren se,

III.1.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përgjithësisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, nisur nga pretendimet e ankimuesit “Adel Co” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.2. Marrë shkas nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Adel Co” SHPK, verifikimi i kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor si dhe specifikimeve teknike, mbi bazën e të cilëve është bërë më pas edhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se kërkesa në specifikime teknike “*Letra:laserBond 90 gsm*” e cila është edhe objekt ankimi, është hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe konkretisht KPP vëren se,

III.1.3. Në shtojcën 9 të dokumenteve të tenderit, kriteret e vecanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, 2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim, pika 2.4.1 autoriteti kontraktor ka kërkuar:

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë 10 (copë) fatura sipas të gjitha specifikimeve teknike të kërkuara në dst, në datën dhe orën e caktuar si afat i fundit për dorëzimin dhe hapjen e ofertave.

III.1.4. Në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike” autoriteti kontraktor ka kërkuar:



PJESA MBRAPA

LOGO UK ME RAJONIN PERKATËS
Me përmasë sa katrori

Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime sh.a.

AD: LREM IPSUM
NPT: A00000000A
TEL/FAX: (+355) 55 555 555 / (+355) 55 555 555
WEB: www.loremipsumat
EMAIL: info@loremipsumat



FATURË TATIMORE SHITJE
MUAJI VITI (dd.mm.yyyy)

EMËR MBIEMËR
Adresa: RR."LOREM IPSUM", PALL. LOREM IPSUM,
SHK. SHK.2 KT.9, AP. AP.2091
4 / F2 / Familjare

NUMRI I FATURËS
000000-0

NUMRI I KONTRATËS
0000000

PERIUDHË FATURIMI
00.00.0000 - 00.00.0000

PLANI TARIFOR
Lorem ipsum dolor sit amet.

NUMRI I MATËSIT 00000000	NUMRI I VULËS 000000	LEXIMI I MUAJIT 00000000	LEXIMI I MËPARSHËM 00000000	KONSUMI I MUAJIT 00000000			
Nr.	Përshkrimi	Njësia e Matjes	Sasia	Gjimi për njësi pa TVSH	Vlefte pa TVSH	Vlefte e TVSH	Vlefte me TVSH
1	2	3	4	5	6=4x5	7=6x20%	8=6+7
1	Shërbim i furnizimit me Ujë	0	0	0	0	0	0
2	Shërbim i Kanalizimeve	0	0	0	0	0	0
3	Tarifë shërbimi	0	0	0	0	0	0
					0	0	0
Nr.	Përshkrimi i Taksave Vendore	Njësia e Matjes	Sasia	Gjimi për njësi pa TVSH	Vlefte pa TVSH	Vlefte e TVSH	Vlefte me TVSH
4	Tarifë pastrimi	0	0	0	0	0	0
5	Taksë e përkohshme për infrastrukturën arsimore	0	0	0	0	0	0
6	Taksë mbi ndertesën	0	0	0	0	0	0
7	Detyrim nga Akt-Marrëveshja	0	0	0	0	0	0

KOMPENSIM

TOTALI PËR TË PAGUAR (LEKË) (fatura duhet paguar deri më datë dd.mm.yyyy)

NJOFTIM: Interuesi abonenti detyrohet në principal të paguajë nga ana luaj janë 0.00 LEK.
Detyrimi i kamatvonesës deri në datën e faturimit është 0.00 LEKË. Fatura duhet të paguhet deri më datë 28.09.2022.

0.00

0.00

LOGO UK ME RAJONIN PERKATËS
Me përmasë sa katrori

EMËR MBIEMËR
Adresa: RR."LOREM IPSUM", PALL. LOREM IPSUM, SHK. SHK.0 KT.0, AP. AP.000

000000-0

MUAJI VITI (dd.mm.yyyy)

VLEFTA PA TVSH	000
VLEFTA E TVSH	000
VLEFTA E TAKSAVE VENDORE	000
KOMPENSIM / SUBVENCION	000
DETYRIM NGA AKT-MARRËVESHJA	000
KAMATË	000
TOTALI PËR TË PAGUAR	000




Specifikimi i Materialeve:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Printimi i faturës dhe palosje në versionin “Selfmailer”

Formati: A4

Letra: LaserBond 90gsm

Fatura duhet të zarfohet në formën “selfmailer” me perforim dhe të paloset në formën “C”

Ngjyra:

Letra e paraprintuar (Logo kryesore në të dyja krahët e faturës si dhe reklama në pjesën e mbrapme) të jetë me ngjyra dhe të dhënat e tjera. Imazhi i letrës mund të ndryshojë çdo tre (3) muaj.

Gjithashtu shuma debitore dhe teksti që e shoqeron si dhe fjala “Debitor” duhet të jetë me ngjyrë të kuqe (për klientët debitorë).

Të dhënat e tjera të faturës me ngjyrë të zezë.

Fatura duhet të ketë dy linja perforimi përgjatë gjatësisë së faturës për hapjen e zarfit si edhe instruksionet përkatëse për hapjen e zarfit. Ngjitje nga krahët anësore. Perforim horizontal tek

linja e treguar. Cdo faturë, në pjesën anësore mbrapa duhet të ketë numrin serial të lotit të fileve, zonën dhe numeratorin për zonë.

Bashkëngjitur edhe një simulim se si duhet fatura (debitore).

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

SHRUKD sh.a do të dergojë filen për imazhin e letrës së parashtypur 30 ditë përpara fillimit të ciklit të radhës së printimit. Ky imazh mund të ndryshojë cdo muaj.

Brenda 2 ditësh nga momenti i marrjes së këtyre të dhenave operatori duhet të përfundojë shërbimin e printimit dhe zarfimit.

III.1.5. Nga informacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor rezulton se operatori ekonomik “Inpress” SHPK ka paraqitur, në përmbushje të kriterit sa më sipër:

- *Mostrat e dorëzuara në autoritet kontraktor*

III.1.6. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.7. Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet, se autoriteti kontraktor ka kërkuar, që operatorët duhet të paraqesin 10 (copë) fatura sipas të gjitha specifikimeve teknike të kërkuara në DST, në datën dhe orën e caktuar si afat i fundit për dorëzimin dhe hapjen e ofertave, ku në specifikime teknike ndër të tjera është kërkuar “*Letra: LaserBond 90gsm*”. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike, është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Duke marrë shkas nga pretendimi i ankimesit që: “*Sipas informacioneve që ne kemi modelet e paraqitura nga firma Inpress nuk përputhen me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit konkretisht për: Gramatura e letres nuk është 90 gr....*” Komisioni gjykon, se kërkesa për paraqitjen e mostrave me specifikimin teknik “*Letra: LaserBond 90gsm*” është kontradiktore dhe krijon konfuzion, si tek operatorët ekonomikë në përgatitjen e ofertave të tyre ashtu edhe tek Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në momentin e vlerësimit të procedurës së prokurimit, pasi nuk mund të kërkohej gramatura e letres për faturën e ujit sepse ajo është një letër e përpunuar e cila ka kaluar nëpër disa procese shtypi deri në sigurimin përfundimtar të saj duke patur ndryshim në përbërjen e saj dhe rrjedhimisht duke ndryshuar në mënyrë thelbësore edhe peshën në gramaturën e letres. KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe Gjykata Europiane e Drejtësisë (GJED) ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar një specifikim teknik të paqartë i cili shkakton konfuzion në përgatitjen e ofertave dhe në mënyrën e

vlerësimit të tyre, si dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik. Kështu që, në lidhje me pretendimin e mësipërm të ankimuesit, nuk mund të garantohet një mjet ankimi efektiv, pasi KPP nuk mund të shprehet mbi themelin e kërkesave, duke qenë se specifikimi teknik “Letra: LaserBond 90gsm” i hartuar nga autoriteti kontraktor është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, si dhe është një kriter i paqartë, i cili shkakton konfuzion në përgatitjen e ofertave si dhe në vlerësimin e tyre. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se kriteret e kualifikimit si dhe specifikimet teknike duhet të përcaktohen të qarta dhe të sakta nga autoriteti kontraktor si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt-prokurimi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi të operatorëve ekonomikë të interesuar, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedurë.

III.1.8. Bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, sipas të cilit: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji, ku thuhet shprehimisht: “*Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj*”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se specifikimi teknik “Letra: LaserBond 90gsm” i përcaktuar nga autoriteti kontraktor nuk është në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik dhe shkakton paqartësi, si te operatorët ekonomikë ofertues ashtu edhe te komisioni i vlerësimit të ofertave dhe kjo përbën shkak për anulimin e procedurës. Në kushtet kur autoriteti kontraktor ka vlerësuar mbi specifikime teknike të paqarta dhe jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të paraqitura nga ankimuesi “Adel Co” SHPK mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK, dhe mbi lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik “Albdesign PSP” SHPK për ekonomi në procesin e shqyrtimit administrativ ato nuk do të merren në shqyrtim pasi referuar arsytimit më sipër të KPP-së procedura e prokurimit do të anulohet dhe ankimuesi nuk ka më interes të ligjshëm mbi pretendimet e tjera të ngritura në ankesë për operatorët ekonomikë “Inpress” SHPK dhe “Albdesign PSP” SHPK pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Akoma më tej lidhur me pretendimet e ankimuesit mbi operatorin ekonomik “Albdesign PSP” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, fati i tij është përcaktuar tashmë prej vendimit të KVO-së ku ky operator ekonomik rezulton i skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi, dhe nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit në përputhje me nenin 110 të LPP-së.

III.3. Lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK në datën 03.11.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, me numër ankimi elektronik A/2025/6041 si dhe nr. Protokolli 3136/2025 datë 04.11.2025 për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr REF-60070-09-02-2025, me objekt: “Sherbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat e SHRUKD sh.a”, me fond limit 25,097,400.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës Sh.A lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit, si dhe lënien të skualifikuar dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit të operatorit ekonomik “Albdesign PSP” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk ka kryer pagesën e tarifës financiare për ankesën e mësipërme, në përputhje me përcaktimet në nenin 111, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku parashikohet se:

- “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.*
- 2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.*
- 3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.*
- 4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”.*

III.3.1. Në gërmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, është parashikuar se:

“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

- a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji”.*

III.3.2. Me datë 10.11.2025 autoriteti kontraktor përmes shkresës me nr. 2285/42 prot., datë 10.11.2025 ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike vendimin për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK protokolluar me tonën me nr.

3136/2 prot., datë 10.11.2025, nga ku rezulton, se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës duke argumentuar:

KSHA referuar nenit 111 të LPP-së, ka kryer verifikimin e elementëve të ankesës dhe ka konstatuar se Operatori Ekonomik ankimues nuk ka ngarkuar mandat-pagesën e tarifës së ankesës.

Duke qënë se mandat-pagesa e tarifës së ankesës është një element i domosdoshm për shqyrtimin e ankesës, KSHA referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, me datë 04.11.2025 i ka dërguar njoftim me email Operatori Ekonomik ankimues me objekt “Mbi paraqitjen e mandat-pagesës së tarifës së ankesës **brenda 2 ditëve** në lidhje me ankesën e paraqitur”.

Operatori Ekonomik ankimues nuk ka korrigjuar (ngarkuar në S.E.A) mandatin e tarifës së ankesës brenda **2 ditëve nga vënja në dijeni me email**.

Përsa më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, në zbatim të pikës 2 dhe 3 të nenit 111 të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM-se, nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

Vendosi:

Të vlerësojë si të paparaqitur ankesën e paraqitur nga Operatori Ekonomik “Inpress” sh.p.k, pasi nuk ka plotësuar një element të domosdoshëm për shqyrtimin e ankesës nuk ka ngarkuar (paraqitur) mandat-pagesën e tarifës së ankesës për prokurimin me objekt **“Shërbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat të SHRUKD”**.

III.3.3. Gjithashtu me datë 07.11.2025 përmes komunikimit elektronik zyrtar (e-mail) i cili u protokollua me tonën me nr. 3136/5 prot., datë 13.11.2025 autoriteti kontraktor i ka përcjellë KPP-së njoftimin që i ka dërguar operatorit ekonomik “Inpress” SHPK me datë 04.11.2025 me përmbajtje si vijon:

“Përshëndetje,

Referuar ankesës suaj të publikuar në faqen zyrtare të KPP me Nr. 3136/2025 për procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbim i printimit dhe zarfimit të faturave për nevoja të SHRUKD” me statusin e mandat pagesës të paparaqitur,

Ju njoftojmë se bazuar në pikën 2 dhe 3 të nenit 111 të Ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

Për sa më sipër duhet të paraqisni mandatin brenda 2(dy) ditëve nga marrja e njoftimit, me qëllim dokumentimin e tij.

Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve, do të vlerësohet si e paparaqitur.

Mbetemi në pritje të përgjigjes tuaj,”

III.3.4. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, sikurse është formulari përkatës dhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa

referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t'i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë *apriori*, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk çënon parimin e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të depozituar në KPP me datë 07.11.2025 përmes komunikimit elektronik zyrtar (e-mail) i cili u protokollua me tonën me nr. 3136/5 prot., datë 13.11.2025 rezultoi, se autoriteti kontraktor ka zbatuar përcaktimet e bëra nga ana e ligjvënësit në pikën 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, duke respektuar hapat proceduralë që parashikon kjo dispozitë ligjore, sepse përmes komunikimit elektronik zyrtar (e-mail), të cilin Komisioni bazuar në nenin 58 pika 3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” në të cilin përcaktohet se: “3. Kërkesa konsiderohet në formë të shkruar edhe kur ajo dërgohet me faks ose në rrugë elektronike, me kusht që të tregojë qartë autorin e saj. Ligji mund të kërkojë që kërkesa të nënshkruhet me dorë.” e konsideron si një formë ligjore komunikimi duke ja bashkëngjitur përmbajtjen e saj materialeve të tjera të fashikullit të shqyrtimit administrativ, i ka kërkuar operatorit ekonomik “Inpress” SHPK, ndreqjen e të metave të ankesës, si në rastin konkret kryerjen e pagesës së tarifës për ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis*, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Komisioni Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi faktet dhe provat bashkëlidhur dokumentacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor thekson, se ky i fundit përmes komunikimit elektronik zyrtar (e-mail) në adresën që vetë ankimesi ka vendosur në ankesë, më datë 04.11.2025 e ka njoftuar në lidhje me korrigjimin e mangësive të konstatuara në lidhje me elementet formale të ankesës, konkretisht pagesës së tarifës së ankesës, nga ku konstatohet se operatori ekonomik ankimes “Inpress” SHPK nuk i është përgjigjur kësaj kërkesë të autoritetit kontraktor, duke mos rregulluar të metat e ankesës. Gjithashtu përmes shkresës me nr. 3136/7 prot., datë 18.11.2025 Sektori i Financës, Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve në KPP ka informuar se: “Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. 3136/6 prot., datë 14.11.2025 me lëndë :”

Kërkesë për verifikim pagese”, ju bëjmë me dije se për ankesën me nr. 3136/2025 prot., datë 04.11.2025 me numër ankimi elektronik A/2025/6041, Operatori ekonomik “Inpress” SHPK nuk ka paraqitur dokument bankar që të vërtetojë kryerjen e pagesës për tarifën e ankimit. Referuar raportit datë 18.11.2025 të dërguar nga Dega e Thesarit për arkëtimet e kryera deri më datë 14.11.2025, rezulton se Operatori Ekonomik “Inpress” SHPK nuk ka kryer pagesën në favor të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesën e sipërcituar.”

Sa më sipër, konstatohet se ankimuesi nuk ka paguar tarifën financiare të ankesës në përputhje me përcaktimet e pikës 2 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar duke mos plotësuar kështu një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës.

Sa më sipër argumentuar, për sa kohë, kërkesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Inpress” SHPK pranë Komisionit Prokurimit Publik dhe autoritetit/entit kontraktor nuk plotëson kushtet formale, siç është pagesa e tarifës kjo ankesë duhet refuzuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Adel Co” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-60070-09-02-2025, me objekt: “Sherbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat e SHRUKD sh.a”, me fond limit 25,097,400.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës Sh.A.
2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

